



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të nenit 40.2 pika I të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenit 23, lista 2 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike dhe nenit 34.2 pika I të Statutit të Komunës, nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2012, mori:

VENDIM

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË AKSIONARËVE PËR FUNKSIONALIZIMIN E NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE STACIONI I AUTOBUSËVE NË PODUJEVË

Neni 1

Për funksionalizimin e Ndërmarrjes Publike Lokale, Stacioni i autobusëve në Podujevë, në propozim të Kuvendit për kryetarin dhe anëtarin e parë dhe emërimin e anëtarit të tretë nga Kryetari i Komunës, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

1. Afërditë Lutfiu, kryetare
2. Kadri Avdiu, anëtar
3. Faik Muçiqi, anëtar

Neni 2

Komisioni do të përkujdeset për lidhjen e marrëveshjes për transferin e aseteve, personelit dhe financave të Stacionit të autobusëve nga Agjencioni Kosovar për Privatizim në Komunën e Podujevës.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas miratimit, përkatësisht 8 ditë pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Nr. 01/219-02
Podujevë,
23 nëntor 2012

Kryesuesi i Kuvendit
Hazir Raçi